

## Republika e Kosovës

## Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më **29 janar 2015**, pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për promovimin dhe fuqizimin e vullnetarizmit të rinjve dhe pjesëmarrjen e rinisë, duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2013 për transparencë nëpër komuna, si dhe nenit 2 të Rregullores për Transparencë 01Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

### V E N D I M PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

#### Neni 1

Ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për promovimin dhe fuqizimin e vullnetarizmit të rinjve dhe pjesëmarrjen e rinisë.

#### Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 30 janar 2015 dhe zgjatë deri më 16 shkurt 2015.

#### Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

#### Neni 4

Obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport që si hartues dhe propozues i Draft-Rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 05/2013, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Gjithashtu DKRS-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Shkurt 2015.



#### Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Shpëtim Zhegrova

Kryesuesi i Kuvendit





**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 12.2 “d” lidhur me nenin 17 “f” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 41.2 “ç” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **29 janar 2015**, mori këtë:

**V E N D I M**  
**PËR CAKTIMIN E KRITEREVE PËR REALIZIMIN E PROJEKTEVE PËR**  
**FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NGA BUXHETI I**  
**KOMUNËS**

**Neni 1**

Me këtë Vendim caktohen kriteret për përfitim të projekteve nga buxheti i komunës për fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në Komunën e Vushtrrisë.

**Neni 2**

Për ofrimin e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale duke përfshirë: **rregullimin e rrugëve lokale, trajtimin e ujërave të zeza, furnizimin me ujë dhe menaxhimin e mbeturinave** përparësi kanë fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të cilat kanë përmbushur obligimet për tatim në pronë në shkallë më të lartë.

**Neni 3**

Me rastin e parashtrimit të kërkesës nga komuniteti për realizimin e projekteve sipas nenit 2 të këtij Vendimi, kërkesës duhet bashkangjitur dëshminë për përmbushjen e obligimeve nga tatimi në pronë.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Kuvendi i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive.

**Neni 5**

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi 01Nr.134/06, dt.10.03.2006.


**Neni 6**

Vendimi hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Shpëtim Zhegrova**

**Kryesues i Kuvendit**





**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 12.2 “d” dhe nenin 40.2 “e” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 41.2 “ç” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **29 janar 2015**, mori këtë:

**V E N D I M**  
**PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E**  
**DRAFT-RREGULLORES PËR TRANSPORTIN RRUGOR NË TERRITORIN E**  
**KOMUNËS SË VUSHTRRIË**

**Neni 1**

Me këtë Vendim formohet komisioni për ndryshimin dhe plotësimin e Draft-Rregullores për transportin rrugor në territorin e Komunës së Vushtrrisë në këtë përbërje:

- 1.1. Safet Osmani (PDK);
- 1.2. Syzana Sylja (LDK);
- 1.3. Mehmet Selaci (LVV).

**Neni 2**

Mandati i këtij komisioni përfundon me rastin e dorëzimit për shqyrtim dhe aprovim në kuvendin e komunës të propozimeve për ndryshim dhe plotësim të Draft-Rregullores për transportin rrugor në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike dhe Komisioni në fjalë.


**Neni 4**

Ky Vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Shpëtim Zhegrova**

**Kryesues i Kuvendit**





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12.2 “d” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 7 të Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenet 30 dhe 31 të Ligjit Nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore, në dispozitat e Rregullores QRK NR.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe nenin 80 “h” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **29 janar 2015**, mori këtë:

**V E N D I M**  
**PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E VENDIMIT 01NR.97/14 DT.24.04.2014**  
**PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM ME KOMPENSIM TË PRONËS SË**  
**PALUAJTSHME TË KOMUNËS – TOKËS BUJQËSORE DHE KULLOSAVE**

**Neni 1**

Me këtë Vendim plotësohet dhe ndryshohet Vendimi për dhënie në shfrytëzim me kompensim të pronës së paluajtshme të komunës – tokës bujqësore dhe kullosave 01NR.97/14 DT.24.04.2014.

**Neni 2**

Neni 1 i Vendimit të lartcekur ndryshohet dhe plotësohet me sa vijon:

2.1. Shtojca 1 e Vendimit, e cila përmban parcelat të cilat jepen në shfrytëzim afatshkurtër me veprimtari kryesisht për kultura “lavërtare” çmimi fillestar të jetë pesëdhjetë (50) euro për një (1) ha në vit, në afat prej tre (3) viteve me mundësi vazhdimi edhe për tre (3) vite tjera.

2.2. Shtojca 2 e Vendimit, e cila përmban parcelat të cilat jepen në shfrytëzim afatgjatë me veprimtari kryesisht për kultura shumëvjeçare “pemishte” çmimi fillestar të jetë pesëdhjetë (50) euro për një (1) ha në vit, në afat prej njëzetë (20) viteve.

**Neni 3**

Për parcelat që jepen në shfrytëzim (me kompensim) afatshkurtër me sipërfaqe deri në dy (2) ha kanë të drejtë të aplikojnë vetëm personat fizikë, ndërsa për parcelat që jepen në shfrytëzim (me kompensim) afatgjatë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm personat juridikë.

#### **Neni 4**

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, si dhe Drejtoria për Inspektime.

#### **Neni 5**

Ky Vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Shpëtim Zhegrova**  
  
**Kryesues i Kuvendit**